

PËRMBLEDHJE

Ecuria e ekonomisë botërore dhe e tregjeve financiare. Gjatë fillimit të vitit 2011, ekonomia botërore është rritur me ritme më të ngadalësuara krahasuar me rritjen mesatare të vitit 2010. Në tremujorin e parë të vitit, norma e rritjes shënoi vlerën vjetore 4.3%, krahasuar me 5% në vitin 2010. Në tremujorin e dytë të vitit, norma vjetore e rritjes ekonomike zbriti në 3.7%, rreth 1.6 pikë përqindje më pak se një vit më parë. Këto zhvillime kanë reflektuar kostot më të larta të tregjeve financiare për financimin e investimeve, si edhe ngadalësimin e kërkesës agregate të sektorit privat që ka përforcuar efektin e uljes së shpenzimeve publike si rezultat i përpjekjeve për konsolidim fiskal.

Ritmet e rritjes ekonomike në vendet e zhvilluara krahasuar me ato në zhvillim, kanë patur një diferencë të theksuar. Në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2011, vendet e zhvilluara kanë shënuar një rritje prej 1.5%, kundrejt 6.8% të vendeve në zhvillim. Gjatë këtij gjashtëmuori, edhe norma e inflacionit në nivel botëror shënoi rritje kryesisht për shkak të ecurisë në rritje të çmimeve të lëndëve të para. Gjithsesi, ecuria e ardhshme e presioneve inflacioniste vlerësohet të jetë në ulje, për shkak të zbutjes së presioneve për rritje të çmimeve të energjisë dhe të lëndëve të para. Për shkak të ritmit më të lartë të rritjes ekonomike, vendet në zhvillim priten të ndeshen me presione më të larta inflacioniste.

Pasiguria që shkakton madhësia e borxheve publike, nivelet e dobëta të konsumit, kushtet e shtrënguara të financimit si edhe kufizimi i ndjeshëm i mundësive për politika ekonomike stimuluese nga autoritetet publike, kanë ulur parashikimet për rritjen e ekonomisë botërore gjatë vitit 2011, në nivelin 4%. Vendet e zhvilluara do të vijojnë të kenë një rritje modeste kryesisht për shkak të ecurisë së ngadalësuar të ekonomisë së SHBA dhe asaj të Eurozonës. Ndërkohë, ulja e kërkesës së huaj do të reflektohet në një rritje ekonomike të vendeve në zhvillim prej 6.4% gjatë 2011 krahasuar me 7.3% të një viti më parë.

Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2011, ekonomia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) është rritur me ritme të ngadalësuara. Në terma vjetorë, ajo u rrit me 0.4% në tremujorin e parë dhe me 1.0% në tremujorin e dytë, duke reflektuar në mënyrë të ndjeshme ngadalësimin e konsumit i cili shënoi një rritje prej vetëm 0.1% në tremujorin e dytë. Kontributi i shpenzimeve publike në rritjen ekonomike ka ardhur në rënie, pasi ato u pakësuan në terma vjetorë me 5.8% në tremujorin e parë dhe me 1.1% në tremujorin e dytë. Në përgjithësi, rimëkëmbja ekonomike e SHBA mbetet e pasigurtë, në kushtet kur ecuria e tregut të shtëpive dhe shpenzimeve konsumatore mbetet e dobët, ndërsa niveli i borxhit publik është tepër i lartë. Për pjesën e mbetur të

vitit, parashikimet për ecurinë e ardhshme të ekonomisë së SHBA reflektojnë ngadalësimin e dy tremujorëve të parë të vitit. Sipas World Economic Outlook², SHBA pritet të rritet me 1.5% në vitin 2011 dhe me 1.8% në vitin 2012.

Edhe vendet e Bashkimit Evropian (BE) e të Eurozonës kanë shënuar një rritje të diferencuar gjatë dy tremujorëve të parë të vitit 2011. Rritja e tyre ishte mesatarisht 2.5% në tremujorin e parë të vitit, krahasuar me 1.9% në të njëjtën periudhë të vitit 2010. Në rritjen ekonomike, kontributin kryesor e dhanë qëndrueshmëria e konsumit dhe e shpenzimeve qeveritare. Të dhënat paraprake për ritmin e rritjes gjatë tremujorit të dytë në vendet e BE-së dhe të Eurozonës, tregojnë për një normë rritjeje më të ulët, rreth 1.7%. Këto zhvillime i referohen ngadalësimit të ritmit të rritjes ekonomike në Gjermani, i cili u përgjysmua në vlerën vjetore 2.8%, si edhe mungesës së rritjes ekonomike në Francë. Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit, presionet inflacioniste në vendet e Eurozonës kanë ardhur në rritje. Për këtë arsye, Banka Qendrore Evropiane (BQE) rriti normën bazë të interesit në prill të 2011 në nivelin 1.25%, me shqetësimin se inflacioni do të vijojë të qëndrojë mbi nivelin e synuar prej 2% gjatë muajve në vazhdim.

Në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore³, ripërtëritja e aktivitetit ekonomik është përshpejtuar në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011, kryesisht e drejtuar nga kërkesa e jashtme. Ndërkohë, kërkesa e brendshme është kufizuar nga tregjet e dobëta të punës, çmimet e larta të lëndëve të para, si edhe nga efektet afatshkurtra të konsolidimit fiskal. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) në terma reale, është përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme në disa nga këto vende. Inflacioni paraqitet disi më i lartë se në fund të vitit 2010 për pjesën kryesore të vendeve të Evropës Qendrore dhe Juglindore, veçanërisht në tremujorin e parë të 2011, duke reflektuar rritjen e çmimeve të energjisë dhe të ushqimeve në këtë periudhë. Sidoqoftë, tremujori i dytë i vitit ka shfaqur nivele më të zbutura të inflacionit. Treguesit afatshkurtër sugjerojnë një vazhdimësi të ripërtëritjes ekonomike në periudhën e ardhshme, për shumicën e këtyre vendeve. Gjithashtu, projeksionet e rishikuara⁴ për Evropën Qendrore dhe Juglindore paraqiten më optimiste në krahasim me vlerësimet paraprake dhe me nivelet e vitit 2010, duke pritur prej këtij rajoni një rritje reale të PBB-së prej 4.3% për vitin 2011.

Ecuria e tregjeve financiare ndërkombëtare. Në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, tregjet financiare botërore kanë shfaqur luhatje, si pasojë e reflektimit të shqetësimeve lidhur me rreziqet e borxhit sovran në Evropë dhe aktivitetit të ngadalësuar ekonomik në SHBA⁵.

Në SHBA politika monetare lehtësuese dhe likuiditeti i bollshëm i kanë mbajtur të ulëta normat e interesit në tregjet e parasë. Ndërsa në Eurozonë, për shkak të presioneve inflacioniste në rritje, norma bazë e interesit⁶ u rrit nga BQE me 25 pikë bazë, në nivelin 1.25%. Normat e interesit të tregut

² Shtator, 2011

³ Sipas ECB Monthly Bulletin, June 2011

⁴ World Economic Outlook, Shtator 2011

⁵ World Economic Outlook Update 17.06.2011

⁶ ECB Monthly Bulletin, June 2011

ndërbankar kanë ndjekur një prirje rritëse të shfaqur gjatë gjithë periudhës gjashtëmuajore.

Normat e kthimit të obligacioneve qeveritare afatgjata në SHBA shfaqën një prirje rritëse që prej fundit të vitit 2010, por gjatë periudhës të analizuar kanë shfaqur luhatshmëri të konsiderueshme. E njëjta ecuri është vënë re edhe për letrat me vlerë të vendeve të eurozonës, ndërkohë që normat e kthimit të letrave me vlerë të qeverisë japoneze kanë patur një ecuri në rënie. Pasiguritë mbi normat e ardhshme të kthimit për obligacionet qeveritare janë rritur, të ndikuar nga paqëndrueshmëria e gjendjes së ekonomisë botërore, pritshmëritë mbi ecurinë e inflacionit dhe rreziqet politike.

Në tregjet e kapitalit, çmimet e aksioneve në bursat kryesore përgjithësisht janë rritur në krahasim me fundin e vitit, të ndikuar nga përmirësimet në situatën financiare të kompanive të tregtuara. Sidoqoftë, pasiguria për zhvillimet ekonomike dhe tensionet gjeopolitike kanë ndikuar në rritjen e luhatshmërisë së këtyre tregjeve.

Në tregjet e këmbimit të valutave, vendimi i Rezervës Federale për mbajtjen e një politike monetare lehtësuese ka ndikuar në dobësimin e dollarit amerikan kundrejt monedhave kryesore. Monedha evropiane ka shfaqur luhatshmëri gjatë këtij gjashtëmuajori, ndikuar kryesisht nga zhvillimet në situatën fiskale të vendeve të ndryshme të Eurozonës. Sidoqoftë, në krahasim me fundin e vitit 2010, monedha evropiane shfaqet e mbiçmuar kundrejt monedhave kryesore.

Në tregjet e lëndëve të para, në krahasim me fundin e vitit 2010, çmimet janë rritur dukshëm në tremujorin e parë të 2011 për të gjitha kategoritë. Kjo rritje paraqitet në kah të kundërt me ngadalësimin e konsumit të tyre në nivel global. Çmimet e ushqimeve u stabilizuan, pas goditjeve të mëparshme në ofertë për shkak të kushteve atmosferike. Pasiguritë mbi të ardhmen e përdorimit të energjisë bërthamore, të shkaktuara nga problemet e krijuara në këtë fushë pas tërmetit në Japoni dhe tensionet politike në disa nga vendet arabe, rritën presionin mbi ecurinë e çmimit të naftës në këtë periudhë.

Ecuria e sektorit bankar, e vlerësuar për grupet e mëdha dhe komplekse bankare (GGMKB), paraqitet e përmirësuar për tremujorin e parë të 2011, duke u bazuar në kapacitetin e tyre për përballimin e goditjeve. Ky përmirësim ka ardhur për shkak të gjendjes më të mirë të kapitalit, kontrollit më të mirë të kostove të veprimtarisë dhe rigjallërimit të fitimeve. Në tremujorin e parë të vitit, kthimi mesatar mbi kapitalin u përmirësua në 7.2% nga 4.5% në fund të vitit 2010. Kthimi mbi aktivet shënoi 0.53% për këtë tremujor, nga 0.34% në tremujorin e fundit të 2010. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit arriti në 13.4% në tremujorin e parë të vitit, për shkak të mosshpërndarjes nga disa banka të një pjese të konsiderueshme të fitimit me qëllim rritjen e kapitalit. Sidoqoftë, për një pjesë të bankave vlerësohet se duhet të arrijnë një cilësi më të lartë të kapitalit dhe të ulin me tej nivelin e levës financiare, për të ruajtur nivelin e besimit të tregjeve dhe për të përballuar më mirë goditjet dhe humbjet e mundshme. Pavarësisht nga përmirësimi i kushteve, mjedisi në të

cilin këto banka operojnë mbetet sfidues, veçanërisht për shkak të ekspozimit të disa prej tyre në borxhin sovran të vendeve periferike të Eurozonës.

Zhvillimet ekonomike në vend. Gjatë tremujorit të parë të 2011 ekonomia shqiptare është rritur, e mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme por edhe nga ritmi më i lartë i zgjerimit të eksporteve dhe rritja e moderuar e importeve, të cilat janë reflektuar në një përmirësim të deficitit tregtar. Sidoqoftë, në tremujorin e dytë, vlerat negative të deficitit të bilancit tregtar janë rritur dhe kontributi i tij në rritjen ekonomike është përkeqësuar. Konsumi privat vijon të zhvillohet me ritme të ngadalta, për shkak se niveli i punësimit dhe të ardhurat nga paga kanë shënuar një rritje të moderuar dhe prirja për kursim shfaqet e qëndrueshme. Dërgesat e emigrantëve vazhdojnë të shënojnë rënie duke ndikuar negativisht në nivelin e konsumit në vend.

Ritmi i rritjes së investimeve në vend ka rënë, duke reflektuar ngadalësimin e kreditimit nga sektori bankar dhe të shpenzimeve kapitale të politikës fiskale. Në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, teprica e kredisë së sektorit bankar është ngjitur në vlerën 518.7 miliardë lekë, rreth 32.5 miliardë lekë ose 6.6% më shumë se në fundin e vitit 2010. Pësia e tepricës së kredisë dhënë jorezidentëve ishte 4.7% , duke shënuar një rritje prej rreth 5.5 miliardë lekë ose 28.6%, në krahasim me fundin e vitit 2010. Në këtë periudhë, teprica e kredisë dhënë jorezidentëve ishte vetëm 3.9% e totalit të kredidhënies së sektorit bankar. Ritmi i rritjes së kredisë në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011 është 2.2 pikë përqindje më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ngadalësimi i rritjes së investimeve është pasojë edhe e ngadalësimit të rritjes së shpenzimeve kapitale. Gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2011 ato janë rritur me 1.82% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Gjithsesi, investimet private janë mbështetur nga përmirësimi i likuiditetit në sektorin bankar përmes rritjes së depozitave. Të gjithë sektorët e ekonomisë, industria, shërbimet dhe ndërtimi kanë shënuar një rritje të shfrytëzimit të kapaciteteve edhe pse vijnë të mbeten poshtë mesatares afatgjatë të tyre. Pritshmëritë për pjesën e mbetur të gjashtëmuajorit të parë 2011 janë pozitive kryesisht për shkak të rritjes së kërkesës së brendshme në industri apo të përmirësimit të aktivitetit ekonomik të shërbimeve dhe zhvillimeve pozitive në sektorin e ndërtimit, të cilat janë reflektuar edhe në tremujorin e parë.

Kontributi i politikës fiskale në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011 është reflektuar kryesisht në terma të rritjes së shpenzimeve korrente. Të ardhurat e përgjithshme kanë shënuar një rritje të ulët prej 1.1% mbi bazë vjetore, ndërkohë që shpenzimet e përgjithshme janë rritur me 7.7%, duke kontribuar në rritjen e deficitit buxhetor në një nivel prej 26.9 miliardë lekë. Përqindja e realizimit të planit vjetor është respektivisht në nivelin e 42.9% për totalin e të ardhurave dhe 44.5% për totalin e shpenzimeve, duke shfaqur vështirësi të dukshme në rritjen e të ardhurave, dhe duke nxitur një proces rivlerësimi të tyre për pjesën e mbetur të vitit. Stoku i borxhit publik është rritur në vlerë absolute me 5% krahasuar me fundin e vitit 2010, duke shënuar një rritje më të madhe të stokut të borxhit të brendshëm, në krahasim me atë të jashtëm⁷.

⁷ Ministria e Financave , “Treguesit e borxhit, gjashtëmuajori i parë 2011”

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2011, deficitin i llogarisë korente vlerësohet në masën 588.5 milionë euro ose 14% të PBB-së, duke u zgjeruar me rreth 4.9 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë. Gjithsesi, krahasuar me fundin e vitit 2010, deficitin i llogarisë korrente është ngushtuar me 2.8 pikë përqindje. Deficitin i bilancit tregtar shënon vlerën 1053.4 milionë euro në të njëjtën periudhë, 14% më shumë se një vit më parë. Në terma të PBB deficitin i bilancit tregtar përbën 24.5%, rreth 4.2 pikë përqindje më shumë se një vit më parë, por duke u ngushtuar me 1.6 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2010. Këto zhvillime reflektojnë ritmet pozitive të rritjes së eksporteve me 12% në terma vjetorë, krahasuar me rritjen prej 13% të importeve. Gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2011, prurjet neto valutore të llogarisë kapitale dhe financiare kanë shënuar vlerën 434.9 milionë euro, rreth 41% më shumë se një vit më parë. Investimet e huaja direkte dhe ato të portofolit janë ngushtuar në terma vjetorë përkatësisht me 15% dhe 68%. Gjithsesi, përmirësimi i transfertave kapitale është reflektuar në një bilanc pozitiv të llogarisë financiare dhe kapitale prej 9.7% të PBB krahasuar me 7.7% që shënoi një vit më parë.

Për sa i përket ecurisë së çmimeve në vend, gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 është vërejtur një rritje e presioneve inflacioniste. Gjatë muajve shkurt dhe maj 2011 inflacioni ka qëndruar mbi nivelin e sipërm të zonës që rrethon objektivin e Bankës së Shqipërisë prej 3% (2%-4%). Këto zhvillime kanë reflektuar kryesisht efektin e rritjes së çmimeve të mallrave ushqimore dhe çmimit të naftës në tregjet botërore. Në përgjigje të këtyre presioneve inflacioniste, në fund të muajit mars Banka e Shqipërisë rriti normën e saj bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje, në nivelin 5.25%. Në terma mesatarë, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, inflacioni shënoi vlerën vjetore 4.0%.

Huamarrja e bizneseve dhe individëve gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011 është zhvilluar me ritme pozitive. Në qershor të 2011, huamarrja⁸ e bizneseve është rritur me 14.6% krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë. Përmirësim ka shënuar dhe huamarrja e individëve e cila është rritur me 5.3% në terma vjetorë, krahasuar me 1.5% që shënoi në fund të vitit 2010 dhe 0.7% në qershor të një viti më parë. Nga ana tjetër, krahasuar me fundin e vitit 2010 bizneset kanë ngadalësuar ritmin e vendosjes së depozitave pranë institucioneve financiare. Në qershor të 2011, bizneset kanë rritur depozitat e tyre me 10.2% në terma vjetorë. Si rezultat, pozicioni debitor i bizneseve, i cili jep diferencën midis pretendimeve të tyre ndaj institucioneve financiare (në formën e depozitave) dhe detyrimeve të tyre ndaj këtyre institucioneve (në formën e huasë së marrë) shënoi vlerën 255.6 miliardë lekë në fund të gjashtëmuajorit të parë 2011, një thellim prej 35 miliardë lekë krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, pozicioni kreditor i individëve arriti në 559 miliardë lekë, duke u zgjeruar me rreth 97.6 miliardë lekë krahasuar me një vit më parë.

⁸ Kjo huamarrje përfshin kredinë e marrë pranë institucioneve financiare që pranojnë depozita (bankave tregtare dhe shoqërive të kursim-kreditit) në formën e kredive të pastra dhe instrumenteve të tjera të borxhit.

Rritja e huamarrjes për bizneset dhe individët siguron plotësimin e nevojave të tyre financiare. Gjithsesi, në varësi edhe të formës së kreditimit, bizneset dhe individët mund të ekspozohen ndaj rrezikut të kreditit në përmasa të ndryshme. Në lidhje me rrezikun e tërthortë të kreditit prej lëvizjeve të pafavorshme në kursin e këmbimit, bizneset paraqesin një ekspozim më të lartë. Ato kanë një pozicion financiar (debitor neto) shumë më të thelluar në valutë krahasuar me pozicionin debitor neto në lekë. Në qershor të vitit 2011, ata janë debitorë ndaj institucioneve financiare për rreth 191.4 miliardë lekë në formën e kredisë në valutë dhe për rreth 64.2 miliardë lekë në monedhën vendase. Pavarësisht përmirësimit të kreditimit gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2011, këto zhvillime janë reflektuar në rritjen e raportit “Teprica e kredisë e pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit ndaj tepricës totale të kredisë” për bizneset.

Në nivel të përgjithshëm të agreguar, individët paraqiten më të mbrojtur ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit, shkaktuar prej nënçmimit të kursit të këmbimit. Në fund të gjashtëmuajorit të dytë 2011, ata rezultojnë kreditorë në valutë të sistemit financiar me 236.7 miliardë lekë. Gjithsesi vlerësohet që rreth 41% e tepricës së kredisë totale për individët të marrë pranë bankave përbëhet nga kredi e pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit, duke treguar se ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit është i pranishëm.

Në lidhje me rrezikun e tërthortë të kreditit shkaktuar prej lëvizjeve të pafavorshme të normës së interesit, vlerësohet që në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, në total, teprica e kredisë me normë të ndryshueshme interesi dhënë për bizneset dhe individët së bashku është rritur me 0.79 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Përsëri bizneset paraqiten më të ekspozuara se individët. Në fakt, 60.8% e tepricës së kredisë për bizneset është dhënë me normë të ndryshueshme interesi. Ky raport është rritur me 1.6 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Për të njëjtën periudhë, rezultoi që 26.5% e kredisë së dhënë për individët ishte me normë të ndryshueshme interesi, duke ndikuar në uljen me 1.4 pikë përqindje të ekspozimit të tyre ndaj rrezikut të normës së interesit.

Zhvillimet në tregun financiar. Tregu financiar shqiptar dominohet nga veprimet e tregut ndërbankar, të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë dhe të këmbimeve valutore. Segmentet e tjera që lidhen me sigurimin, risigurimin dhe fondet e pensionit përbëjnë një pjesë të vogël të vëllimit të përgjithshëm të tregut financiar.

Krahasuar me gjashtëmuajorin e dytë 2010, në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011 është shënuar rënie e vëllimit të transaksioneve në tregun ndërbankar me 22.7%, në një kohë kur mesatarja e ponderuar e interesit ka ruajtur pothuaj nivel të njëjtë. Në tregun e letrave me vlerë të borxhit të qeverisë, kërkesa e pjesëmarrësve ka qenë përgjithësisht më e madhe se oferta. Megjithatë, që prej muajit janar 2011 ecuria e normave të kthimit në tregun primar të borxhit të qeverisë ka rinisur rritjen, si rezultat i rritjes së huamarrjes nga ana e qeverisë. Rritja më e theksuar e normave të kthimit është vërejtur për borxhin me maturim 12 muaj, duke u ndjekur më pas nga normat e kthimit të obligacioneve të indeksuara me këtë tregues.

Për sa i takon kostos së ndërmjetësimit nga ana e sektorit bankar, vërehet që diferenca midis normës mesatare të kredive dhe normës mesatare të depozitave për veprimet në lekë është ngushtuar me 0.04 pikë përqindjeje, si pasojë e rënies më të lartë të normës mesatare të interesit të kredisë në lekë kundrejt normës së depozitave në monedhën vendase. Në krahasim me muajin dhjetor 2010, spread-i është zgjeruar me 2.04 pikë përqindje për veprimet në dollar amerikan dhe është zgjeruar me 0.44 pikë përqindje për veprimet në euro, përkatësisht prej rritjes së normës mesatare të interesit të kredisë në dollar amerikan me 2.1 pikë përqindjeje dhe rritjes më të lartë të normës së kredisë në euro kundrejt depozitave në euro.

Në tregun e brendshëm, në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011 euro është mbiçmuar kundrejt lekut me 1.9% ndërsa dollari amerikan dhe paundi britanik janë nënçmuar respektivisht me 6.1% dhe 3.3%. Mbiçmimi i lekut kundrejt dy monedhave të fundit ka reflektuar kryesisht zhvillimet në tregjet ndërkombëtare të këmbimit valutor.

Funksionimi i mirë i sistemeve të pagesave AIPS dhe AECH, të cilat administrohen nga Banka e Shqipërisë ka mbështetur veprimtarinë e tregut financiar. Numri i transaksioneve është rritur gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011 me rreth 3.9% në sistemin e shlyerjes së pagesave me vlerë të madhe AIPS dhe 34.7% në sistemin me vlerë të vogël AECH. Gjatë periudhës janar-qershor 2011, në total u procesuan rreth 5.6 milionë transaksione me karta (ATM dhe POS) me një qarkullim total prej 56 miliardë lekësh. Nga totali i transaksioneve, rreth 96% e përfaqësojnë tërheqjet cash nga ATM-të dhe vetëm 4% janë pagesa klientësh me karta në POS-e, tregues ky i një ekonomie ende me përdorim të lartë të cash-it.

Zhvillime të sistemit financiar. Niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i vlerësuar si raport i aktiveve të sektorit financiar⁹ ndaj PBB-së¹⁰ është vlerësuar në nivelin 86.9% në gjysmën e parë të vitit 2011, nga 85.9% në fund të vitit 2010 dhe nga 84.4% referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Vëllimi i aktiveve të institucioneve financiare u rrit me rreth 5% krahasuar me fundin e vitit 2010. Sektori bankar vijon të mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, aktivet e të cilit përfaqësonin rreth 94.5% të totalit të aktiveve të sistemit financiar dhe rreth 82.2% të PBB-së. Sektori financiar jobankar vijon të zërë një peshë të vogël ndaj tërësisë së sistemit financiar. Kështu, totali i aktiveve të sektorit financiar jobankar¹¹ përfaqëson rreth 5.5% të sistemit financiar, peshë në rënie me fundin e vitit 2010, prej 5.7%. Aktiviteti i sektorit jobankar përfaqëson rreth 4.8% të PBB-së së vendit, nga 4.9% që llogaritej në fund të vitit 2010.

⁹ Sistemi financiar përbëhet nga: bankat, institucionet financiare jobanka, shoqëritë e sigurimit, shoqëritë e kursim-kreditit dhe fondet e pensionit private suplementare.

¹⁰ Parashikim i FMN-së për PBB-në nominale e shpërndarë nëpër tremujorë bazuar mbi shpërndarjen e PBB-së reale tremujore, që publikon INSTAT. Për vitin 2011, vlera e PBB-së ka rezultuar rreth 1,321.5 miliardë lekë.

¹¹ Baza e të dhënave për institucionet financiare jobanka, shoqëritë e sigurimit dhe SHKK-të i përket tremujorit të parë të vitit 2011, ndërsa për fondet e pensionit suplementar të dhënat i përkasin fundit të vitit 2010 (sipas publikimit të AMF-së).

Zhvillime të sektorit bankar. Në gjysmën e parë të vitit 2011, aktivet e sektorit bankar u ngjiten në nivelin 1,043.9 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 5.4% kundrejt fundit të vitit 2010 dhe 11.7% kundrejt një viti më parë.

Në përbërjen e aktiveve të sektorit bankar, portofoli i kredive (pa përfshirë interesat e llogaritura¹²) u ngjit në vlerën 518.7 miliardë lekë, duke u rritur me 6.6% ndaj fundit të vitit 2010. Kredia në valutë zë rreth 68.7% të totalit të kredisë. Aktivet e sektorit bankar në valutë arritën nivelin 547.9 miliardë lekë, duke shënuar rritje me 4.3% kundrejt muajit dhjetor 2010. Investimet e sektorit bankar në mjete të subjekteve jorezidente, u ngjiten në nivelin 129 miliardë lekë, duke u rritur me 6% ndaj fundit të vitit 2010 dhe me 23.5% ndaj një viti më parë. Bankat e Grupit 3, përfaqësonin 81.7% të vlerës së përgjithshme të këtyre investimeve. Ndërkohë, vetëm vendosjet e sektorit bankar pranë institucioneve jorezidente vlerësohen në masën 69.4 miliardë lekë, prej të cilave 59 miliardë lekë ishin në formën e llogarive rrjedhëse e të depozitave dhe 10.4 miliardë lekë në formën e kredive.

Në përbërjen e detyrimeve të sektorit bankar, depozitat (pa përfshirë interesat¹³ e llogaritura) arritën vlerën rreth 842.5 miliardë lekë, duke shënuar rritje me 4.6% kundrejt fundit të vitit 2010. Fondet e veta arritën në nivelin 105.3 miliardë lekë, duke qenë 0.5% më të larta se në fund të vitit 2010. Detyrimet në valutë arritën në nivelin 525.4 miliardë lekë, duke u rritur me 4% kundrejt fundit të vitit 2010. Detyrimet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve, u vlerësuan në masën 66.2 miliardë lekë, duke shënuar rritje me 37% krahasuar me muajin dhjetor 2010 dhe me 7.7% në krahasim me një vit më parë. Vlera e linjave të kreditit të përfituara nga grupet bankare zotëruese dhe të përdorura, vlerësohet në rreth 19.5 miliardë lekë. Pjesa e angazhuar por e papërdorur¹⁴ e linjave të kreditit nga grupet bankare zotëruese, vlerësohet në rreth 46.1 miliardë lekë. Në fund të gjysmës së parë të vitit 2011, zërat jashtë bilancit përfaqësonin 97.8%¹⁵ të totalit të aktiveve të sektorit bankar nga 88.7% në fund të vitit 2010, duke shënuar rritje me 16.2% për këtë periudhë dhe me 12.1% në krahasim me një vit më parë.

Në fund të muajit qershor 2011, kapitali i paguar i sektorit bankar ishte 73.1 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 2.4 miliardë lekë ose 3.4%, nga fundi i vitit 2010, si rezultat i injektimit të kapitalit të kryer në disa banka të sektorit. Kapitali i paguar përfaqëson 7% të totalit të aktiveve, pothuaj në të njëjtin nivel me fundin e vitit 2010, por në rritje nga një vit më parë. Për situatën e likuiditetit të veprimtarisë së sektorit bankar, veçojmë që në muajin qershor 2011 depozitat e sektorit bankar përfaqësojnë 82.1% të totalit të detyrimeve, duke qenë rreth 0.4 pikë përqindjeje më pak se në fundin e vitit 2010. Aktivet likuide të sektorit bankar, u ngjiten në nivelin 266.7 miliardë lekë, duke zënë rreth 25.5% të totalit të aktiveve të sektorit. Ky tregues ka rënë me rreth 0.4 pikë përqindjeje në krahasim me muajin dhjetor të vitit 2010.

¹² Vlerësohen në rreth 4.7 miliardë lekë.

¹³ Llogariten në vlerën 14.4 miliardë lekë.

¹⁴ E regjistruar si zë jashtë bilancit.

¹⁵ Në qershor 2010, zërat jashtë bilancit përbënin 97.4% të totalit të aktiveve të sektorit bankar.

Në gjysmën e parë të vitit 2011, rezultati neto ishte pozitiv, në masën 1.1 miliardë lekë, duke qenë rreth 69 për qind më i ulët se për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Fitimi i sektorit bankar vijon të mbetet i përqendruar në bankat më të mëdha. Kthimi mbi aktivet (RoA), i kthyer në bazë vjetore, ka rezultuar 0.22% nga 0.79% për të njëjtën periudhë një vit më parë. Kthimi mbi kapitalin (RoE), i kthyer në bazë vjetore, ka rezultuar 2.4%. Në gjysmën e parë të vitit 2010 ky tregues ishte 8.31%.

Vlerësimi i rreziqeve të veprimtarisë. Në vijim analizohen rreziqet e veprimtarisë së sektorit bankar që lidhen kryesisht me rreziqet e tregut, të likuiditetit dhe të kreditit. Në vijim, vlerësohet pozicioni i kapitalizimit të veprimtarisë të sektorit bankar.

Për sa i takon rreziqeve të tregut, vlerësohet se ndikimi i rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit dhe të normës së interesit në bilancin e bankave, është i ulët. Ky ndikim diktohet prej vlerës së ulët të pozicionit të hapur në valutë, në rastin e rrezikut të kursit të këmbimit, si edhe të vlerës së moderuar të diferencës midis aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit, në rastin e rrezikut të normës së interesit.

Për sa i takon rrezikut të likuiditetit, situata paraqitet e qëndrueshme, pothuaj e njëjtë me fundin e vitit 2010. Në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2011, raporti i aktiveve likuide me pasivet afatshkurtra (me maturim deri në një vit) rezultoi 30.2% kundrejt 30.6% në fund të vitit 2010 dhe 32.8% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sipas monedhave, vlera e raportit paraqitet më e lartë për lekun dhe për dollarin, por më e ulët për euron. Konkretisht, për lekun rezulton 41.2%, për dollarin 28.5% dhe për euron 14.9%. Diferencat midis aktiveve dhe pasiveve sipas strukturave kohore të maturimit¹⁶, si për zërat e bilancit ashtu edhe pas përfshirjes së zërave jashtë bilancit, rezultojnë në vlera negative. Këto diferenca mbulohe disa herë nga vlera e aktiveve likuide, duke paraqitur një aftësi të mirë për pagesën e detyrimeve në momentin e maturimit të tyre. Sidoqoftë, në këtë kuadër nevojitet të monitorohet me kujdes situata e likuiditetit në valutë, veçanërisht ajo në monedhën euro. Raporti kredi/depozita rezultoi në nivelin 61%, shumë pranë nivelit të fundit të vitit 2010, megjithatë 2.2 pikë përqindje më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në harkun kohor prej një viti, depozitat janë rritur me rreth 3.9 pikë përqindje më shumë se kredia. Raporti kredi/depozita për veprimet në valutë ka shënuar 87.4%, duke rezultuar 1.5 pikë përqindje më shumë se fundi i vitit 2010 dhe rreth 7.8 pikë përqindje më i ulët se e njëjta periudhë të një viti më parë. Raporti kredi/depozita në lek rezultoi 36.7% nga 35.4% referuar fundit të vitit 2010. Rritja e treguesit ka ardhur si rezultat i ritmit më të lartë të rritjes së kredive në lekë (10.4%) në krahasim me depozitat në lekë (6.5%), që prej fundit të vitit 2010.

Një formë tjetër e administrimit të nevojave afatshkurtra për likuiditet është huamarrja në tregun ndërbankar ose nga Banka e Shqipërisë. Përgjithësisht, kjo është një huamarrje e kolateralizuar; lloji dhe mjaftueshmëria e aktiveve të cilat mund të shërbejnë si kolateral në këtë rast, janë elemente të tjera

¹⁶ Duke supozuar mbajtjen deri në maturim të aktiveve dhe të pasiveve.

që duhen monitoruar për të vlerësuar aftësinë e bankave mbi plotësimin e nevojave të tyre për likuiditet në afat të shkurtër.

Rreziku i kreditit vijon të mbetet rreziku kryesor për sektorin tonë bankar. Në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, raporti i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë, mbi baza bruto, u ngjiti në nivelin 17%, kundrejt 13.9% në fund të vitit 2010 dhe 12.2% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Raporti “kredi me probleme neto ndaj kapitalit rregullator”, është ngjitur në nivelin 48.8%, rreth 12.5 pikë përqindjeje më shumë se fundi i vitit 2010. Cilësia e portofolit të kredisë ka shënuar rënie si për bizneset, ashtu edhe për individët. Raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë për bizneset dhe për individët llogaritet përkatësisht 19.1% dhe 13.9%, krahasuar me 15.5% dhe 11.7% në fund të vitit 2010. Gjithashtu, cilësia e portofolit të kredisë sipas monedhës, ka rënë si për portofolin e kredisë në lekë ashtu edhe për atë në valutë. Treguesit “kredi me probleme në lekë/tepricës së kredisë në lekë” dhe “kredi me probleme në valutë/tepricës së kredisë në valutë” u llogariten përkatësisht në nivelet 16.7% dhe 17.1%, krahasuar me 14.4% dhe 13.8%, që rezultuan në fund të vitit 2010. Lidhur me cilësinë e kredisë sipas sektorëve ekonomikë, dallohet sektori i “Ndërtimit” me vlerën më të lartë të treguesit në fjalë prej 28%, ndjekur nga sektori i “Tregtisë” dhe ai i “Industriës përpunuese” respektivisht prej 20% dhe 18%. Vlera e raportit “kredi me probleme/tepricën e kredisë” është e lartë edhe për sektorin “Hotele dhe restorante”, në nivelin 27%, megjithëse pesha e kreditimit të këtij sektori në totalin e tepricës së kredisë është vetëm 2.9%.

Në përgjigje të situatës së rrezikut të kredisë, sektori bankar ka vijuar të shtojë fondet e veta rezervë për përballimin e humbjeve të mundshme. Në fund të gjysmës së parë të vitit 2011, fondet rezervë (provigjionet) për përballimin e humbjeve nga rreziku i kreditit u ngjiten në nivelin 46 miliardë lekë, rreth 27.3% më shumë se niveli i tyre në dhjetor 2010. Raporti i provigjioneve me kredinë me probleme (bruto) ra në nivelin 51.7%, nga 52.7%, që llogaritej në fund të gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2010, duke mbetur pranë nivelit të mesatares historike 5-vjeçare prej rreth 51%. Raporti i provigjioneve ndaj totalit të tepricës së kredisë (bruto), u ngjiti në nivelin 8.8%, krahasuar me 7.4% në fund të dhjetorit 2010 dhe 6.4% një vit më parë. Gjithashtu, mbulimi me kolateral i portofolit të kredisë me probleme llogaritet në nivelin 81.7% e portofolit të kredisë, nga 79.3% që llogaritej në fund të vitit 2010.

Rënia e cilësisë së kredisë dhe nevoja për të rritur fondet rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, dëmton aftësinë e sektorit bankar për të gjeneruar një rezultat financiar pozitiv, në nivele të mjaftueshme për të mbështetur rritjen e kapitalit me burime të brendshme dhe për të lejuar zgjerimin normal të kaluar. Për të njëjtën periudhë, kostot e operative të veprimtarisë së sektorit bankar janë rritur me vetëm 1.7%. Për këtë arsye, vlera e rezultatit operativ bruto ka rezultuar pozitive për 10.4 miliardë lekë, rreth 3.9% më e lartë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo tregon që sektori bankar ka mundur të ruajë nivele të qëndrueshme të të ardhurave neto prej aktivitetit bankar. Por më tej, krijimi i rezervave për humbjet e mundshme nga aktivet (kryesisht nga kredia) gjatë periudhës ka qenë rreth 8.8 miliardë

lekë, rreth 3 miliardë lekë më i lartë se në gjashtëmuorin e parë të vitit 2010, duke diktuar rënien e rezultatit financiar neto (pas taksave) në masën 1.1 miliardë lekë. Nëse rreziqet në aktivitetin kreditues mbeten të qëndrueshëm, aftësia e sektorit bankar për të ruajtur një nivel të mjaftueshëm të rezultatit operativ bruto mund të rrezikohet. Për këtë çështje, nëpërmjet funksionit të saj mbikëqyrës Banka e Shqipërisë ka kërkuar nga bankat tregtare që ato të sigurojnë paralelisht identifikimin e saktë dhe në kohën e duhur të kredive me probleme dhe krijimin e fondeve përkatëse rezervë, si edhe të realizojnë veprime të vendosura për rikuperimin e vlerave të kredive të humbura nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve. Këto veprime, të kombinuara me masat për uljen e mëtejshme të kostove operative dhe përshejtimin e kredidhënies, do të krijojnë gradualisht kushtet për gjenerimin e një rezultati financiar të qëndrueshëm dhe pozitiv, i cili do të mbështeste më mirë nevojat afatmesme për kapital të sektorit bankar.

Në lidhje me aftësinë paguese, në fund të gjysmës së parë të vitit 2011, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, i cili vlerëson mbulimin me kapital të veprimtarive me rrezik të sektorit bankar, rezultoi në nivelin 14.6%, duke qenë rreth 0.7 pikë përqindje më i ulët se në fund të vitit dhe 1.6 pikë përqindje më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Niveli minimal i këtij treguesi i përcaktuar nga kuadri rregullativ është 12%.

Për vlerësimin e rreziqeve me të cilat ndeshet sektori bankar, Banka e Shqipërisë realizon në mënyrë të vazhdueshme ushtrime që provojnë rezistencën e sektorit bankar ndaj zhvillimeve të pafavorshme të supozuara në disa tregues makroekonomikë dhe financiarë, më vete dhe të kombinuar.

Këto ushtrime tregojnë që sektori bankar, paraqitet i ndjeshëm ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit që buron prej lëvizjeve në kursin e këmbimit dhe në normat e interesit. Kanali i përcjelljes së rrezikut në rastin e kursit të këmbimit është pjesa e portofolit në valutë ku huamarrësi nuk ka të ardhura të mjaftueshme në valutë. Në rastin e normave të interesit, kanali i përcjelljes së rrezikut lidhet me portofolin e kredisë me norma interesi të ndryshueshme. Në këtë rast duhet mbajtur parasysh fakti që normat e interesit të referencës, veçanërisht për valutën, gjenden pranë niveleve të ulëta historike dhe situata e paqëndrueshme ekonomike botërore sugjerojnë që ato mund të qëndrojnë pranë këtyre niveleve edhe në të ardhmen e parashikueshme. Megjithatë, faktorë të ndryshëm që lidhen me situatën gjeopolitike, ecurinë e çmimit të lëndës së parë, paqëndrueshmërinë e kursit të këmbimit të monedhave dhe politikat monetare stimuluese, mund të sjellin goditje në ecurinë e inflacionit dhe të shkaktojnë rritje të normave të interesit që shërbejnë si referencë për portofolin e kredive në vend. Në sektorin bankar shqiptar, rritja e normës së interesit për kreditë, ndonëse mund të ndodhte në mënyrë graduale, do të shoqërohej me rritjen e ngarkesës për kredimarrësit duke ndikuar mbi aftësinë e tyre paguese. Për këtë arsye, bankat tregtare duhet ta konsiderojnë një mundësi të tillë në skenarët e tyre të rrezikut dhe duhet të jenë të gatshme të krijojnë në kohën e duhur rezervat përkatëse.

Pas zbatimit të skenarëve të ndryshëm, rezultatet e provës së rezistencës tregojnë se sektori bankar në tërësi, mbetet i qëndrueshëm referuar mjaftueshmërisë dhe cilësisë së kapitalit. Megjithatë, ndjeshmëria e bankave individuale ndaj këtyre goditjeve të supozuara është rritur. Vijimi i prirjes rënëse të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit do të zvogëlonte aftësinë e sektorit bankar për të përballuar goditje të ndryshme dhe mund të shoqërohej me rënie të këtij treguesi nën nivelin minimal të kërkuar në banka të veçanta. Për këtë arsye, është e nevojshme që secila bankë të vlerësojë nevojat për kapital shtesë duke patur parasysh pritshmëritë për ecurinë e rezultatit financiar dhe të elementeve të tjerë përbërës të llogarisë së kapitalit, si edhe të sigurojë një ritëm më të lartë të rritjes së kapitalit krahasuar me ritmin e rritjes së aktiveve me rrezik. Në këtë analizë, bankat duhet të aplikojnë skenarë rreziku konservatorë, për të siguruar në kohën e duhur një nivel optimal mbrojtjeje.

Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë vlerëson dhe ka kërkuar që sektori bankar duhet të fuqizojë kapitalizimin e veprimtarisë në afat të shkurtër, nëpërmjet rritjes së kapitalit nga aksionerët. Banka e Shqipërisë e ka orientuar dhe monitoruar nga afër këtë proces, në mënyrë që ai të kryhet në përputhje me strategjitë e zhvillimit të veprimtarisë bankare dhe ecurinë e rreziqeve përkatëse. Procesi i forcimit të treguesve të kapitalizimit në sektorin bankar përfshin krijimin e madhësive të mjaftueshme të kapitalit mbi nivelin minimal të kërkuar. Procesi vijon të ecë sipas përcaktimeve në komunikimin që Banka e Shqipërisë ka zhvilluar me sektorin bankar. Si rezultat i këtyre masave, sektori bankar do të mbetet i qëndrueshëm dhe do të krijojë kushtet për rritjen e kontributit të tij në zhvillimin ekonomik të vendit.